

P.nr. 665/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, gjyqtari i vetëm gjykues Naser Foniqi, me procesmbajtësen Sevdije Breznica, në çështjen penale të pandehurit R.K, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par. 3, lidhur me par.1, të KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.661/17, të datës 20.02.2017, në shqyrtimin e dytë, të hapur për publikun, të mbajtur me datë 19.05.2017, në të cilin ishin të pranishëm: Prokurori i shtetit Musa Mehaj, i pandehuri R.K, pas seancës, me datë 19.05.2017, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri R.K, i biri i H dhe F, e vajzërisë Gj, i lindur me datë *data e lindjes*, në fshatin C, Komuna O, tani me banim në O Lagja H, me numër personal *numri personal*, i pa shkolluar, i martuar- baba 5 fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, rom, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e: me datë 29.01.2017, rreth orës 01:18, në rr. "...", në O, i pandehuri R.K pas një mosmarrëveshje të mëhershme dhe të vazhdueshme që ka me bashkëshortin e tij-tani të dëmtuarën V.K, e cila pas një bisede me bashkëshortin e saj për arësye që ta mbroj rejtjen e saj, i pandehuri e ka kapur për flokëshdhe duke e hedhur për toke e duke i thënë se "kam me të mbytur krejt", me ç'rast e dëmtuara ka pësuar ndrydhje të indeve të buta në regjionin e kokës dhe qafës dhe si të tilla paraqesin dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin,-

- me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par. 3, lidhur me par.1, të KPRK.

Prandaj gjykata në bazë të neneve: 41; 50; 51; 52; 76, par.1.5 dhe 188, par. 3, lidhur me par.1, të KPRK, si dhe nenit 365, të KPP, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

- Në kohëzgjatje prej **tre (3) muaj burgim**, i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej **1 (një) viti**, në qoftë se i pandehuri Rexhep Krasniq, gjatë kësaj kohe nuk do të kryej vepër të re penale.
- I pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, për shkak të gjendjes së tij ekonomike.
- **E dëmtuara V(D) K**, nga O, rr. "...", pa numër, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

ARSYETIMI

Pas kallëzimit penal të Policisë së Kosovës – Stacioni Policor në Obiliq, nr.2017-AJ-0035, të datës 02.02.2017, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.661/17, të datës 20.02.2017, ka akuzuar të pandehurin R.K, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par. 3, lidhur me par.1, të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit të dytë të datës 19.05.2017, i pandehuri R.K, ka kërkuar fjalën dhe ka deklaruar se në këtë fazë të procedurës e pranom fajësinë për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke shtuar se ka qenë nervoz pasi që e dëmtuara nuk ia ka dhënë një cigare edhe pse në paqetë i kishte 3 cigare, pastaj i pandehuri ka kërkuar nga gjykata që të ketë parasysh se ai është i sëmurë nga depresioni, gjumin e bënë vetëm me tableta qetësuese dhe është i gjendjes së rëndë ekonomike, jeton në fukarallak, në një barakë ku nuk ka rrymë as ujë.

Sa i përket pranimit të fajësisë nga i pandehuri, Prokurori i shtetit ka deklaruar, se e pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri, mbetet në tërësi pranë aktakuzës, konsideron se pranimi i fajësisë është mbështetur në provat materiale, prova këto nga të cilat është ngritur edhe aktakuza, andaj vlerëson se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kurrëfarë presioni dhe mbështetur në këto prova, andaj gjykatës i ka propozuar që me rastin e matjes së lartësisë së dënimit pranimin e fajësisë ta marrë si rrethanë lehtësuese.

Pas deklarimit të të akuzuarit se ndihet fajtorë për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi është bindur se ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht, dhe i mbështetur në faktet që përmban aktakuza.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit R.K, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 188, par. 3, lidhur me par.1, të KPRK, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtorë të akuzuarin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur; sinqeritetin e treguar gjatë shqyrtimit të dytë; rrethanat në të cilat është kryer vepra penale; pranimin e fajit për veprën e kryer penale; rrethanat personale të kryesit, se është i sëmurë dhe i gjendjes së rëndë ekonomike, ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese, prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41, të KPRK.

Në rastin konkret, gjykata ka marrë në konsideratë se rreziku penal dhe vlera e dëmshme e veprës penale ka qenë relativisht e vogël dhe vepra penale nuk ka rezultuar me dëme të konsiderueshme të vlerës së mbrojtur.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë, në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPK, e dëmtuara është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453, par. 4, të KPPK, pasi që pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të të pandehurit dhe personave që ai detyrohet t'i mbështes materialisht, përkatësisht pesë fëmijëve dhe bashkëshortes së tij.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 365, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 22.05.2017.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.665/17, datë 19.05.2017.

Procesmbajtëse,
Sevdije Breznica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Naser Foniqi

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.